



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Nr. 6386 Prot.

Vau Dejës 14.09.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim.

Z. Ervis Shimaj

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projektvendimin, për:

“Për krijimin e (SHBB) “Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor Vau Dejës” si person juridik dhe miratimin e akteve të themelimit”

Me respekt,

KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Aleksandra GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

**DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETETE
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

PROJEKT VENDIM

Nr./2 datë 17.09.2026

**“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSORE (SHBB) VAU DEJËS
SI PERSON JURIDIK DHE AKTEVE TË THEMELIMIT”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1.1 shkronja “b”, pika 1.6 shkronja “b”, neni 54, shkronja “d” e ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr. 38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, dhe për aq sa zbatohet ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, titujt II, III dhe IV, i ndryshuar, propozimin e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, i propozojmë Këshillit të Bashkisë, të:

VENDOSI

- Krijimin e Shoqërisë me emërtimin tregtare SHBB “Shoqeria e Bashkëpunimit Bujqësor Vau Dejës”, me objekt veprimtarie: Gjedhe, dele, dhi, derra, shpendë; grumbullim, ftohje, ruajtje, standardizim, paketim, transport dhe tregtim të qumështit, mishit, vezëve; blerje të përbashkëta; shërbime teknike/veterinare; si dhe Prodhimet e serave, grumbullim, seleksionim, kalibrim, standardizim, paketim, ruajtje, ftohje, transport dhe tregtim; blerje inputesh; kontraktim; përpunim kur lejohet; markim dhe eksport.
- Miratimin e aktit të themelimit dhe statusit të shoqërisë SHBB “Shoqeria e Bashkëpunimit Bujqësor Vau Dejës”,. Të ngarkojë kryetarin e Bashkisë apo personin e autorizuar prej tij, që të nënshkruaje aktet e themelimit të kësaj shoqërie tregtare.
- SHBB “Shoqeria e Bashkëpunimit Bujqësor Vau Dejës”,, organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin nr. 38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, për aq sa zbatohet ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, dhe legjislacionit në fuqi.
- Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 12 pjesë, Zadrime Agrikulture Shpk zotëron 51% dhe themeluesit e shoqërisë 49%.
- SHBB “Shoqeria e Bashkëpunimit Bujqësor Vau Dejës” të ketë selinë qendrore në adresën: Kosmace, Njesia Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës, Shqipëri.
- SHBB “Shoqeria e Bashkëpunimit Bujqësor Vau Dejës”, të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar.
- Pas themelimit të saj, shoqëria regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

SHBB "Shoqeria e Bashkepunimit Bujqesore Vau Dejes", ka në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, të drejtën për të shqyrtuar dhe vlerësuar mundësinë e bashkëpunimit me shoqëri të tjera dhe të hyje në marrëdhënie kontraktuale me persona të tretë.

- Bashkia Vau Dejes i siguron shoqërisë SHBB "Shoqeria e Bashkepunimit Bujqesore Vau Dejes", nga inventari i saj i pronave të paluajtshme, mjediset e nevojshme për regjistrimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.
- Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Aseteve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
Aleksandra GJONI



“SHOQERIA E BASHKËPUNIT BUIQËSOR VOU DEJËS”

STATUTI

KAPITULLI I

Neni 1 **EMRI I SHOQERISE**

Emri i Shoqërisë është "Shoqeria e Bashkepunimit Buiqësor Vau Dejes" ("Shoqëria"), i cili paraprihet në mënyrë të pandashme nga fjalët "Shoqëri e Bashkëpunimit Buiqësor", të cilat përfaqësojnë formën ligjore të saj.

Anëtarët e Shoqërisë ("Anëtarët") janë përgjegjës për detyrimet e shoqërisë deri në vlerën e kontributeve të nënshkruara të kapitalit të shoqërisë të përfaqësuar në kuota ("Kuota").

Në të gjitha shkresat, publikimet dhe dokumentat e shoqërisë, emërtimi i saj paraprihet nga fjalët "Shoqëri e Bashkëpunimit Buiqësor", pas të cilave shënohet emërtimi i shoqërisë dhe numri i regjistrimit të saj. Gjithashtu, në dokumentat, faturat, reklamimet dhe botimet e Shoqërisë, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, shënohen dhe:

adresa e regjistruar, dhe

pasqyrimin e faktit që shoqëria është në procedura likuidimi, në qoftë se ky rast paraqitet.

Në asnjë rast një shoqëri tjetër nuk mund të përdorë emërtimin e përcaktuar në nenin 1.1 të këtij statuti.

Neni 2 **FORMA LIGJORE**

Shoqëria është një subjekt i së drejtës shqiptare dhe ka formën ligjore të një shoqërie bashkëpunimi bujqësor, në përputhje me ligjin nr. 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Buiqësor".

Neni 3 **SELIA**

Selia e Shoqërisë është Kosmaçe, Njesia Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejes, Shqipëri. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë.

Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kohezgjatja

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj për një kohezgjatje të pacaktuar.

Kapitulli II

Objekti

Neni 5 Objekti i Shoqërisë:

Shoqëria ka për objekt kryerjen e veprimtarive të mëposhtme:

SHBB-ja krijohet për organizimin ekonomik të fermerëve në sektorin e blegtorisë, pularisë dhe prodhimit të perimeve të serave, për blerje të përbashkëta, shërbime, grumbullim, standardizim dhe tregtim kolektiv dhe për rritjen e eficiencës dhe të ardhurave të anëtarëve.

Prodhimin, përpunimin, grumbullimin, ruajtjen, transportimin, marketingun dhe tregtimin e produkteve bujqësore në gjendjen e tyre natyrale dhe të përpunuara.

Organizimi i veprimtarive edukuese dhe trajnimeve të specializuara të cilat janë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e shoqërisë.

Në përputhje me ligjislacionin Shqipëtar, në mënyrë që të arrihet qëllimi I sipërmenduar, Shoqëria ka të drejtë:

Të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhënie marrje me qira,

Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI III

ANETARËT

Neni 6 Kushtet për të qene anetare

Anetare të shoqërisë janë personat fizik dhe juridik të cilët përbushin nevojat dhe intereset e tyre lidhur me veprimtarinë që ushtrojnë në fushën e prodhimit, nëpërmjet shërbimeve, mallrave dhe produkteve të ofruara nga Shoqëria.

Në qëllim përbushjen e objektit të shoqërisë, anëtarët janë të detyruar të marrin pjesë dhe të përbushin politikat ekonomike dhe sociale të Shoqërisë.

Numri i anëtarëve është i pakufizuar, por në çdo rast nuk mund të jetë më i vogël se 7.

Çdo anëtar duhet të jetë i madhore dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar. Përkundrazi juridik anëtar duhet të kenë fituar personalitetin juridik dhe ndaj tyre nuk duhet të ketë filluar asnjë procedurë likuidimi apo falimentimi.

Nuk mund të jenë anetare personat fizik ose juridik që kryejnë veprimtari konkurruese me veprimtarinë e shoqërisë, përveçse kur kjo veprimtari zhvillohet në kuadër të cilësise së tij si anëtar i shoqërisë. Gjithashtu, nuk mund të jenë anetare personat fizik ose juridik që bashkëpunojnë me ata që zhvillojnë veprimtari konkurruese në të njëjtin sektor me shoqërinë, përveç rasteve kur asamblëja e përgjithshme vendos që është në interesin më të lartë të shoqërisë që ata të jenë anetare.

Neni 7 Të drejtat e anëtarëve

Anëtarët kanë të drejta dhe përgjegjësi të mëposhtme

- a) të propozojnë ndryshimin e administratorëve të shoqërisë.
- b) të propozojnë ndryshime apo përmirësime të statutit.
- c) të kërkojnë dhe të disponojnë kopje të statutit, të rregullores së brendshme apo të vendimeve të organeve drejtuese të shoqërisë, kryesisht, kur preken interesat e tyre.
- ç) të kërkojnë dhe të marrin të dhëna për gjendjen financiare dhe ekonomike të tyre brenda shoqërisë.
- d) të informohen, sa herë që depozitojnë kërkesë me shkrim, lidhur me gjendjen financiare të shoqërisë, kryesisht, për:
 - i) llogaritë vjetore financiare;
 - ii) raportin e veprimtarisë së shoqërisë;
 - iii) mënyrën dhe procedurat e ndarjes së fitimit;
 - iv) raportet e ekspertëve kontabël;
- dh) të informohen rregullisht për mbledhjet e asamblesë së përgjithshme, duke përfshirë në informacion pikat e rendit të ditës, dokumentacionin e përgatitur për mbledhje, si dhe të dhëna të tjera, të cilat lidhen me vendimmarrjen për çështje të caktuara, të cilat mund të prekin interesat e tyre.

Administratori është i detyruar të informojë me shkrim anëtarin për çështjet e trajtuara në kërkesën e tij brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së saj.

Anëtari kërkuar ka të drejtë të kundërshtojë refuzimin e dhënies së informacionit, duke iu drejtuar gjykatës brenda 30 ditëve nga njoftimi për refuzimin.

Neni 8 Detyrimet e Anëtareve

Anëtarët janë të detyruar të përmbushin detyrimet e parashikuara në ligj e në statut dhe veçanërisht:

1. të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme;
2. të zbatojnë marrëveshjet e miratuara nga organet e shoqërisë;
3. të marrin pjesë në veprimtari që përbëjnë objektin e shoqërisë, sipas përcaktimeve të statuteve, përveçse kur asambleja e përgjithshme, në rast të një shkakut të justifikueshëm, mund të përjashtojë nga ky detyrim anëtarin në masën që i takon dhe sipas rrethanave;
4. të ruajnë sekretin për ato çështje dhe të dhëna të shoqërisë, përhapja e të cilave mund të dëmtojë interesat e ligjshëm të saj;
5. të mos kryejnë veprimtari konkurruese me veprimtarinë e shoqërisë, përveçse kur kjo veprimtari zhvillohet në kuadër të cilësisë së tij si anëtar i shoqërisë dhe objektit të saj dhe të mos bashkëpunojnë me ata që zhvillojnë veprimtari konkurruese në të njëjtin sektor me shoqërinë, me përjashtim të rasteve kur autorizohen formalisht nga asambleja e përgjithshme;
6. të marrin pjesë në veprimtaritë e formimit dhe të kualifikimit;
7. të kryejnë derdhjen e kontributeve të tyre në kapitalin e shoqërisë në mënyrën e parashikuar;
8. të përmbushin detyrimet e tjera, që rrjedhin nga ligji dhe statuti.

Neni 9 Largimi i anëtarit

1. Anëtari mund të largohet nga shoqëria:

- vullnetarisht, me anë të dorëheqjes;
- i detyruar, me anë të përjashtimit në rastet e parashikuara në këtë ligj;
- kur, nëse statuti nuk e pengon, transferon pjesën e zotëruar prej tij në kapitalin e shoqërisë të një individ ose person juridik, i cili ka marrë miratimin e asamblesë së përgjithshme për të qenë anëtar;
- në rast likuidimi, kur anëtari është person juridik;
- në rast falimentimi;
- në rast vdekjeje;
- në çdo rast tjetër, të përcaktuar në ligj apo në statut.

2. Administratori shprehet me vendim të motivuar për largimin e anëtarit, për secilin prej rasteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, dhe vendimin e marrë ia përcjell për miratim asamblesë së përgjithshme.

3. Administratori është i detyruar të shenojë në regjistrin e anetareve, që mbahet nga shoqëria si dhe të regjistrojë në qendrën Kombetare të Biznesit largimin e anetareve dhe çdo veprim, i cili ndryshon kapitalin e nënshkruar apo mënyrën e ndarjes së tij, si rrjedhojë e largimit të anëtarit.

KAPITULLI IV

Neni 10 Asambleja e përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme është organ vendimmarrës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqërisë.

2. Asambleja zgjedh kryetarin dhe sekretarin. Rregullat dhe kriteret për zgjedhjen e tyre, periodha e veprimtarisë dhe procedura e shkarkimit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

3. Asambleja e përgjithshme, përveç sa mund të parashikohet në statut, ka këto kompetenca:

- a) vendos drejtimin e politikave ekonomike të shoqërisë;
- b) analizon raportin e gjendjes financiare, përfshirë llogaritë vjetore, shpërndarjen e fitimeve, ngarkimin e humbjeve, menaxhimin financiar dhe çështje të tjera të veprimtarisë ekonomike, që çmohen të rëndësishme;
- c) emëron dhe shkarkon administratorin/ët, ekspertin/ët kontabël dhe likuiduesin/it, si dhe përcakton masën e shpërblimit të tyre;
- ç) miraton zvogëlimin apo zmadhimin e kapitalit;
- d) miraton ndryshime të statutit;
- dh) vendos për shpërndarjen apo mënyrën e përdorimit të fitimit të shoqërisë, sipas dispozitave të këtij ligji dhe statutit;
- e) vendos shkëmbimin, ndarjen, transformimin apo shpërbërjen e shoqërisë;
- ë) vendos për ndryshime të strukturës ekonomike, shoqërore, organizative apo funksionale të shoqërisë;
- f) vendos për pjesëmarrjen në forma të tjera të bashkëpunimit ekonomik edhe me anë të pjesëmarrjes në kapital, aderimin në organizata me karakter përfaqësues dhe shkëputjen prej tyre;
- g) miraton pasqyrat financiare, raportet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shoqërisë, raportet e ekspertëve kontabël dhe të likuiduesve;
- gj) miraton pranimin e anëtarëve të rinj dhe pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë, si dhe largimin apo përjashtimin e tyre;
- h) kryen detyra dhe çështje të tjera të përcaktuara në ligj apo në statut.

4. Për çështjet që shqyrton, asambleja e përgjithshme merr vendimet përkatëse, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

Neni 11 Thirrja e Asamblese së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara me ligj, në statut apo sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme thirret të paktën një herë në vit dhe brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët ose nga anëtarët e përcaktuar sipas pikës 4 të neni 14 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim, jo më vonë se 30 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Gjithsesi, në raste urgjente ky afat mund të reduktohet në 15 ditë. Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) emërtimin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;
- b) rendin e ditës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

Neni 12 Procesverbali i Mbledhjes

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe nga sekretari.
Kryetari i Asamblese së Përgjithshme zgjidhet Z. Sabah Ymeri.
Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të sekretarit, si dhe rezultatet e votimit.
Procesverbali dhe dokumentet e bashkëlidhura duhet të ruhen për një periudhë 5-vjeçare dhe anëtarët mund të kërkojnë kopje të tyre.

Neni 13 Administratori

1. Shoqeria administrohet nga 1 Administrator, të drejtat dhe detyrimet e të cilit janë të parashikuara në ligjin për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësorë, në Statutin e Shoqërisë

Administratori i Shoqërisë është: z. Sabah Ymeri

Kohezgjatja e funksionit të Administratorit është për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë merr fuqi ligjore, me të drejtë rizgjedhjeje

Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë së shoqërisë, duke zbatuar politikat e përcaktuara nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve, të regjistrave dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatitin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqesin këto dokumente asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem informimi dhe vlerësimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas këtij ligji;

e) i raportojnë asamblesë së përgjithshme për zbatimin e orientimeve dhe për realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;

ë) kryerjen e cdo detyrë tjetër të caktuar në ligje, nga Asambleja e përgjithshme si dhe nga Akti i Emerimit të tij.

Administratori mbikëqyr dhe siguron që zyrtaret, agjentet, të punësuarit, auditorët dhe këshilltarët e shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbajnë sa më mirë interesat e shoqërisë.

Kapitulli V

Neni 14 Regjimi Ekonomik

Kapitali i Regjistruar

Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë është në total 100,000 (njëqind mijë) leke. Kapitali ndahet në 12 kuota, plotësisht të nënshkruara dhe të shlyera.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë zotërohet nga Anëtarët si më poshtë vijon;

Nr.	Anëtar	Kuota	Vlera (lekë)	%
1	Zadrima Agrikulture Shpk	1		51%
2	Halim Elezi	1		4,45 %
3	Ymer Ymeri	1		4,45 %
4	Ardi Maldi	1		4,45 %
5	Fatjon Ramadan Elezi	1		4,45 %
6	Nasuf Maldi	1		4,45 %
7	Nazim Ymeri	1		4,45 %
8	Fatmir Salja	1		4,45 %
9	Ferid Ymeri	1		4,45 %
10	Osman Ymeri	1		4,45 %

11	Vullnet	Haxhani	I	4,45 %
12	Ramazan	Zallina	I	4,45 %

KREU VI

Neni 15 Ndryshimi I Formes Ligjore Dhe Prishja e Shoqerise

Prishja e Shoqerise se Bashkepunimit Bujqesor

- Shoqëria shkrihet dhe hyn në proces likuidimi për shkaqet e mëposhtme:
- vullneti i anëtarëve, i manifestuar nëpërmjet vendimit të asamblesë së përgjithshme;
- përmbushja e plotë e objektit të shoqërisë ose pamundësia për ta përmbushur atë;
- zvogëlimi i numrit të anëtarëve nën minimumin ligjor të nevojshëm, për të krijuar një shoqëri, sipas dispozitave të ligjit, nëse numri i nevojshëm i anëtarëve nuk rivendoset brenda një periudhe prej 6 muajsh;
- bllokimi i veprimtarisë vendimmarrëse të ndonjërit prej organeve të shoqërisë ose mosushtimi i veprimtarisë së shoqërisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare;
- reduktimi i kapitalit të shoqërisë nën minimumin e përcaktuar në ligj, nëse nuk rivendoset brenda një periudhe gjashtëmujore;
- nisja e procedurave të falimentimit;
- mos ushtrimi i veprimtarisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare dhe mosnjohimi i pezullimit të veprimtarisë, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"
- nëse shoqëria rezulton me humbje për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare
- me vendim të gjykatës;
- për çdo arsye tjetër, të përcaktuar në ligj.

Neni 16 Likuidimi

Përveç rasteve kur kundrejt shoqërisë është hapur një procedurë falimentimi të personit juridik, sipas dispozitave të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin", të ndryshuar, verifikimi i një prej shkaqeve të përmendura në nenin 45 të ligjit për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, ka si pasojë hapjen e fazës së likuidimit të shoqërisë në gjendjen e aftësisë paguese.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas vendimit të prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër.

Likuiduesi emërohet nga gjykata në rastet kur shoqëria prishet me vendim të gjykatës.

KREU VII

TË NDRYSHME

Neni 17 DISPOZITAT E FUNDIT

Në qoftë se ndonjë nga dispozitat e këtij statuti ose ndonjë dispozitë që bëhet pjesë e statudit në të ardhmen është e pavlefshme ose e pazbatueshme, pjesërisht apo plotësisht, apo vlefshmëria apo zbatueshmëria e saj humbet në të ardhmen, apo statuti përmban mangësi, nuk do të ndikohet vlefshmëria e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme apo e pazbatueshme ose me qëllim rregullimin e mangësive - do të zëvendësohet nga një dispozitë tjetër, sipas vendimit të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me parashikimet ligjore, e cila duhet të reflektojë në mënyrën më të përafërt vullnetin fillestar të anëtarëve.

Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga legjislacioni përkatës shqiptar.

ANETARET THEMELUES

- | | |
|------------------------|---------|
| 1. Zadrime Agrikulture | Shpk |
| 2. Halim | Elezi |
| 3. Ymer | Ymeri |
| 4. Ardi | Maldi |
| 5. Fatjon Ramadan | Elezi |
| 6. Nasuf | Maldi |
| 7. Nazim | Ymeri |
| 8. Fatmir | Salja |
| 9. Ferid | Ymeri |
| 10. Osman | Ymeri |
| 11. Vullnet | Haxhani |
| 12. Ramazan | Zallina |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE

SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Nr. — Prot

Vau Dejes, 17.09.2026

RELACION

“PËR KRIJIMIN E (SHBB) SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSORE VAU DEJËS SI PERSON JURIDIK DHE AKTEVE TË THEMELIMIT”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1.1 shkronja “b”, pika 1.6 shkronja “b”, neni 54, shkronja “d” e ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr. 38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, dhe për aq sa zbatohet ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, titujt II, III dhe IV, i ndryshuar, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Aseteve i parashtron Këshillit Bashkiak relacionin si me poshtë vijon:

Ligji nr. 38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor” parashikon se Shoqëria e bashkëpunimit bujqësor është një organizim vullnetar ndërmjet personave fizikë ose juridikë, me qëllim përmbushjen e nevojave apo interesave të tyre në fushën e prodhimit, të përpunimit dhe të tregtimit të produkteve bujqësore e blegtorale, kryesisht por pa u kufizuar, nëpërmjet marrëveshjeve apo bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet tyre dhe shoqërisë për shërbime, mallra apo produkte të sektorit bujqësor ose blegtoral, si dhe nëpërmjet promovimit të veprimtarive të tyre ekonomike.

Krijimi i Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësore SHBB me emërtimin tregtarë “SHOQËRIA SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSORE VAU DEJËS” ka si qëllim organizimin ekonomik të fermerëve të blegtorisë dhe pularisë, për uljen e kostove, standardizimin, fuqizimin e negocimit dhe krijimin e një zinxhiri të organizuar nga ferma deri tek tregu.

SHBB-ja krijohet për organizimin ekonomik të fermerëve në sektorin e blegtorisë, pularisë dhe prodhimit të perimeve të serave, për blerje të përbashkëta, shërbime, grumbullim, standardizim dhe tregtim kolektiv dhe për rritjen e eficiencës dhe të ardhurave të anëtarëve.

Nga pikëpamja e aktivitetit që do të ushtrojë shoqëria, ajo do të funksionojë si një strukturë e posaçme dhe e specializuar në grumbullim, ftohje, ruajtje, standardizim, paketim, transport dhe tregtim të qumështit, mishit, vezëve; blerje të përbashkëta; shërbime teknike/veterinare; si dhe prodhimet e serave, grumbullim, seleksionim, kalibrim, standardizim, paketim, ruajtje, ftohje, transport dhe tregtim; blerje inputesh; kontraktim; përpunim kur lejohet; markim dhe eksport.

Shoqëria do të ketë si objekt veprimtarie si me poshtë vijon:

Marrëdhënia me prodhimin

Anëtari ruan pronësinë mbi fermën dhe mjetet e tij. Produkti i dorëzuar të SHBB-ja trajtohet sipas marrëveshjes/rregullores.

Grumbullimi

SHBB-ja organizon peshimin, pranimin, regjistrimin, kontrollin e cilësisë, ruajtjen dhe transportin.

Çmimi dhe pagesa

Metodologjia e çmimit, komisionet, kostot dhe afatet e pagesës përcaktohen paraprakisht dhe dokumentohen.

Tregtimi kolektiv

SHBB-ja negocion dhe lidh kontrata me blerës, organizon shitje kolektive dhe zhvillon tregje.

Blerjet e përbashkëta

SHBB-ja mund të organizojë blerje të përbashkëta të inputeve, ushqimeve, materialeve dhe shërbimeve.

Cilësia dhe gjurmueshmëria

Zbatohen kërkesat për sigurinë ushqimore, gjurmueshmërinë, higjienën, zinxhirin e ftohjes dhe vetëkontrollin/HACCP kur kërkohet; pranimi dokumentohet sipas fermës, sasisë, datës, lotit/ngarkesës dhe cilësisë.

Kriteret e pranimit, peshimi, regjistrimi, loti/fermeri, standardet e paketimit dhe ruajtjes dhe gjurmueshmëria përcaktohen me rregullore teknike dhe sipas kërkesave të tregut e sigurisë ushqimore.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 12 pjesë, Zadrime Agrikulture Shpk zotëron 51% dhe themeluesit e shoqërisë 49%.

Çdo themelues/anëtar paguan kuotë anëtarësimi prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh. Kuota paguhet një herë, në momentin e pranimit dhe nuk zëvendëson pjesën e kapitalit, kontributin vjetor ose pagesat për shërbime.

Janet e SHBB-së janë Asambleja e Përgjithshme dhe Administratori. Detyrat dhe kompetencat e organeve janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar sipas Ligjit nr. 38/2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor" dhe Statutit të saj.

Bashkia mund të mbështesë SHBB-në brenda kompetencave të saj ligjore, përfshirë lehtësimin e aksesit në ambiente/infrastrukturë dhe koordinimin institucional. Kjo mbështetje nuk krijon automatikisht pjesëmarrje në kapital dhe nuk i jep Bashkisë administrimin e shoqërisë.

Zona e Vaut të Dejës mbart një potencial të jashtëzakonshëm në sektorin e blegtorisë, rritjes së shpendëve dhe prodhimeve në sera. Suksesi i kësaj shoqërie bazohet në ndërthurjen e tre nënsektorëve që plotësojnë natyrshëm njëri-tjetrin. Sektorët e blegtorisë dhe pularisë sigurojnë një burim të vazhdueshëm të ardhurash gjatë gjithë vitit përmes qumështit, mishit e vezëve, por gjithashtu shërbejnë edhe si furnizues të lëndës së parë organike për pasurimin e tokave të serave. Nga ana tjetër, prodhimet e serave sigurojnë perime të hershme me kërkesë të lartë në treg, gjë që garanton praninë e vazhdueshme në treg. Gjatë këtij procesi, është thelbësore të kuptohet se kuadri ligjor garanton plotësisht që toka, kafshët dhe serat mbeten në pronësi private të secilit fermer.

KRYETARI
Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
Aleksandra GJONI



AKT THEMELIMI – SHOQËRIA E BASHKËPUNITIT BUJQËSOR VAU DEJËS”

Sot, më ____/____/2026, në Vau Dejës, në mbështetje të Ligjit nr. 38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor” dhe legjislacionit në fuqi, themeluesit e mëposhtëm vendosin të themelojnë një Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor.

Neni 1

Themeluesit

Nr.	Emër/Mbiemër	NID/NIPT	Adresa	Nënshkrimi
1	Zadrima Agrikulture Shpk	K56705007O	Vau Dejes	
2	Halim Elezi	L58401792T	Kosmaç	
3	Ymer Ymeri	L57210158B	Kosmaç	
4	Ardi Maldi	L57116193M	Kosmaç	
5	Fatjon Ramadan Elezi	L76611136J	Kosmaç	
6	Nasuf Maldi	L57127021E	Kosmaç	
7	Nazim Ymeri	L57211023Q	Kosmaç	
8	Fatmir Salja	L66815132B	Kosmaç	
9	Ferid Ymeri	L57422135G	Kosmaç	
10	Osman Ymeri	L57407133G	Kosmaç	
11	Vullnet Haxhani	L57126013I	Kosmaç	
12	Ramazan Zallina	M67108131O	Kosmaç	

Neni 2

Emërtimi, forma dhe selia

Emërtimi i shoqërisë është “Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor Vau Dejës”. Forma juridike është Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB). Selia: Kosmac, Njësia Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës, Shqipëri.

Neni 3

Qëllimi dhe objekti

SHBB-ja krijohet për organizimin ekonomik të fermerëve në sektorin e blegtorisë, pularisë dhe prodhimit të perimeve të serave, për blerje të përbashkëta, shërbime, grumbullim, standardizim dhe tregtim kolektiv dhe për rritjen e eficiencës dhe të ardhurave të anëtarëve.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria themelohet me afat të pacaktuar.

Neni 5

Kapitali themeltar dhe pjesët

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 12 pjesë, Zadrima Agrikulture Shpk zotëron 51% dhe themeluesit e shoqërisë 49%.

Pjesëmarrja e çdo themeluesi pasqyrohet në tabelën e mëposhtme dhe në regjistrat e shoqërisë.

Nr.	Anëtar	Nr. pjesëve	Vlera (lekë)	%
1	Zadrima Agrikulture Shpk	1		51%
2	Halim Elezi	1		4.45 %
3	Ymer Ymeri	1		4.45 %
4	Ardi Maldi	1		4.45 %
5	Fatjon Ramadan Elezi	1		4.45 %
6	Nasuf Maldi	1		4.45 %
7	Nazim Ymeri	1		4.45 %
8	Fatmir Salja	1		4.45 %
9	Ferid Ymeri	1		4.45 %
10	Osman Ymeri	1		4.45 %
11	Vullnet Haxhani	1		4.45 %
12	Ramazan Zallina	1		4.45 %

Neni 6

Kuota e anëtarësimit

Çdo themelues/anëtar paguan kuotë anëtarësimi prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh. Kuota paguhet një herë, në momentin e pranimit dhe nuk zëvendëson pjesën e kapitalit, kontributin vjetor ose pagesat për shërbime.

Neni 7

Statuti

Themeluesit miratojnë Statutin e SHBB-së si dokumentin rregullues të veprimtarisë dhe deklarojnë se do ta respektojnë atë.

Neni 8

Administratori

Administrator i parë emërohet: z.Sabah Ymeri, me mandat sipas statutit dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Organet

Organet e SHBB-së janë Asambleja e Përgjithshme dhe Administratori, sipas Ligjit nr. 38/2012 dhe Statutit.

Neni 10

Veprime me të tretët

Shoqëria mund të kryejë veprimtari dhe shërbime në kuadër të objektit të përcaktuar në statut, përveç se me anëtarët e saj edhe me persona fizikë ose juridikë, të tretë, jo anëtarë, deri në 40 për qind të totalit të të ardhurave nga veprimtaritë e saj, gjithmonë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 11

Bashkia Vau Dejës

Bashkia mund të mbështesë SHBB-në brenda kompetencave të saj ligjore, përfshirë lehtësimin e aksesit në ambiente/infrastrukturë dhe koordinimin institucional. Kjo mbështetje nuk krijon automatikisht pjesëmarrje në kapital dhe nuk i jep Bashkisë administrimin e shoqërisë.

Neni 12

Vendimi për regjistrim

Themeluesit autorizojnë Administratorin të kryejë procedurat e regjistrimit dhe depozitimit të dokumenteve pranë QKB-së dhe organeve të tjera kompetente.

Neni 13

Dispozita përfundimtare

Ky akt hartohet në tri kopje me të njëjtën fuqi. Çdo çështje e paparashikuar rregullohet nga Ligji nr. 38/2012, Statuti dhe legjislacioni në fuqi.

NËNSHKRIMET E THEMELUESVE

Nr.	Emër/Mbiemër	Nënshkrimi
1	Zadrima Agrikulture Shpk	
2	Halim Elezi	
3	Ymer Ymeri	
4	Ardi Maldi	
5	Fatjon Ramadan Elezi	
6	Nasuf Maldi	
7	Nazim Ymeri	
8	Fatmir Salja	
9	Ferid Ymeri	
10	Osman Ymeri	
11	Vullnet Haxhani	
12	Ramazan Zallina	

DOKUMENTACIONI I LIDHUR

Ky akt shoqërohet me Statutin, dokumentet identifikuese të themeluesve dhe dokumentet e tjera të kërkuara për regjistrim. Rregullorja e anëtarësisë dhe marrëveshja fermer-SHBB janë dokumente të veçanta.